# DËSHMI ARKIVI

**A-444670**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "E meritoj" – Yamali e sheh vetëm një rival për Topin e Artë |
| ADRESA | `https://www.koha.net/futboll/e-meritoj-yamali-e-sheh-vetem-nje-rival-per-topin-e-arte` |
| BURIMI | koha.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 15 shtator 2026, 01:37:23 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 16:03:30 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `bcd3fb4db0ed27ffbb56048a71396e1d5d9aa7855c167a8ebe0c30a43bf9cf6d` |
| TEKSTI | `d0d53fede8a02aabb29277cbeeb9109615f781199b89ac42f64a6ada473c6f67` |
| PAMJA | `670d31c56543cc6778e04d8b617ffa1f3070d3224148ab0745e93bfb8adcf9c5` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `844ee23d554d34766035153a1fccf6b5a6637bd056ae3e71343114171744ca95` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `339a441950953cdd8a76a2c095ab2238d5bab62fcc252abcef1242a6a5fba2fb` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/844ee23d554d34766035153a1fccf6b5a6637bd056ae3e71343114171744ca95`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën Kontribuo → Letër lexuesit

FUTBOLL

# “E meritoj” – Yamali e sheh vetëm një rival për Topin e Artë



Foto: Associated Press

14 shtator 2026 18:03

Shpërndaje në:

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Kur kampanja e zgjedhjeve futet në fazën vendimtare, kandidatët shfaqen, si në sport ashtu edhe në politikë.

Disa javë para ceremonisë së Topit të Artë, Lamine Yamal po bënë përpjekje për ta shtyrë veten para, ndonëse periudha e vlerësimit sportiv ka përfunduar.

Në fitoren 4:2 të Barcelonës ndaj Levantes, 19-vjeçari ka shënuar dy gola. Nga dy gola i ka në tri ndeshjet e fundit kampionale të Barçës. E kishte edhe një gol e dy asistime në fitoren 5:1 ndaj Feyenoordit në Champions.

Supertalenti spanjoll i ka pasuar veprimet e tij me fjalët për Topin e Artë.

“Mendoj se e meritoj këtë vit për shkak të arriturave të mia”, ka thënë Yamal në një intervistë për “MovistarPlus”.

Edhe



Futboll • 8 sht 2026
Dembele, Kane e Mbappe favoritë për Topin e Artë

Ceremonia e Topit të Artë mbahet më 26 tetor. Bëhet fjalë për çmimin më të njohur individual në sport, që i ndahet futbollistit më të mirë të vitit.

Yamali e sheh Kylian Mbappen e Real Madridit si rivalin më të madh.

“Kujt do t'ia jepja? Lojtarit më të mirë në botë. Kujt do t'ia japin ata? Është diskutim i gjatë. Jam i bindur se ne të dy jemi më të mirët në botë”, ka vazhduar Yamal.

“Për mua kjo është e qartë dhe secili që e përcjell sportin e di këtë”.

Para ndeshjes në Ligën e Kampionëve ndaj Interit, Mbappe po

**Arbëri.**
Mustafa: Jam takuar me Kurtin për ta diskutuar platformën time për zhbllokimin institucional

**Futboll.**
Newcastle pëson debakël nga Leedsi

**Futboll.**
Spektakël në Serie A, Interi fiton 5:3 ndaj Udineses

**Futboll.**
Kosova i luan 4 ndeshje brenda 16 ditësh grumbullim

**Arbëri.**
VV-ja pas tërheqjes së Sejdiut: Ishte mundësia që çështja e presidentit të zgjidhej, por u bllokua sërish

**LAJMET E MBRËMJES.**
Mbrojtja kërkon lirimin e Thaçit e katër të tjerëve në rastin për pengim të drejtësisë

ashtu e bëri të qartë ambicien e tij.

Edhe



Botërori 2026 • 17 kor 2026

Pse finalja e Botërorit mund të jetë vendimtare në garën për “Topin e Artë”

“Kur luani për Real Madridin, ju automatikisht jeni të lidhur me këtë çmim”, kishte thënë Mbappe, duke kujtuar që u bë golashënuesi më i mirë në histori të Kupës së Botës vetëm disa javë më parë.

“Kam bërë histori këtë verë, por do të shohim. Është vit i mirë për këtë dhe njerëzit duhet të votojnë”, ka shtuar francezi, që po ashtu ka nisur shkëlqyeshëm edicionin e ri duke i realizuar shtatë gola në gjashtë ndeshje garuese.

Në një intervistë për “France Football”, Mbappe tha: “Për kë do të votoj? Për veten”.

Ndonëse e fitoi Kupën e Botës me Spanjën, Yamali e shikon prapa Botërorin me ndjenja të përziera.

Edhe



Botërori 2026 • 13 kor 2026

Mbappe e Yamal përballen sërish

“Pasi e fitova Kupën e Botës, nuk isha i kënaqur. Kam bërë shumë gjëra që njerëzit nuk i kanë parë. Për trajnerin është e jashtëzakonshme të ketë një lojtar që mund të kujdeset për tre kundërshtarë, por unë nuk isha i lumtur për veten pasi një lojtar tjetër i kalibrit tim do të kishte Botëror të shkëlqyer”.

Yamali dhe Mbappe nuk janë kandidatët e vetëm seriozë për Topin e Artë. Votimi pritet të jetë interesant si asnjëherë më parë.

#LAMINE YAMAL #TOPI I ARTE

## Artikuj të ngjashëm



Futboll • 24 sht 2025

Lamine Yamal – paralajmërimi i një epoke të re futbolli

Futboll • 22 sht 2025

Të hënën “Topi i Artë”, Dembele pritet të jetë fituesi

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.



Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 / [email protected]

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.